



FUNKSIONI I PËRPUTHSHMËRISË

Departamenti i Përputhshmërisë është përgjegjës për menaxhimin e riskut të përputhshmërisë së Bankës.

Departamenti i Përputhshmërisë ka linje raportimi direkte tek Drejtori i Përgjithshëm, raporton në Komitetin e Kontrollit dhe është subjekt i auditeve të kryera nga Divizioni i Auditit të Brendshëm përsa i përket përshtatshmërisë dhe efektivitetit të procedurave të tij, në linjë me udhëzimet e Bankës dhe “Programit të Përputhshmërisë”.

Përgjegjësitë kryesore të Departamentit përfshijnë:

- Përfaqësimin e Bankës tek autoriteti mbikëqyres dhe autoritete të tjera, si dhe komunikimi me to.
- Parandalimi dhe mos lejimi i pastrimit të parave.
- Ruajtja e sekretit bankar.
- Parandalimi dhe mos lejimi i mashtrimit.

Departamenti i Përputhshmërisë, është administrativisht i pavarur dhe ka akses të pakufizuar tek të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme për të përmbushur misionin e vet.

Departamenti harton Programin Vjetor të Përputhshmërisë, në linjë me kuadrin rregullator në fuqi, si dhe me Politikën dhe Procedurat e Përputhshmërisë të Bankës dhe të Grupit.

Departamenti, ndër të tjera, bashkëpunon me Divizionin e Auditit të Brendshëm, Departamentin e Shërbimeve Ligjore dhe Divizionin e Menaxhimit të Riskut, me qëllim adresimin e përbashkët të çështjeve mbi mbikëqyrjen e kuadrit rregullator.